



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 18
Prishtinë, më 23.01.2009 ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N.225

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë,
Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Fatmire Berisha, Adem Hajdaraj,
Heset Cakolli, Memli Krasniqi, Gani Buçinca, Enis Kervan dhe Mark Krasniqi .

Munguan: Donika Kadaj-Bujupi dhe Dragan Dimiq

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës: Skënder
Boshtrakaj dhe Naser Hoti

Nga zyra e Komisioneve të Kuvendit: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i implementimit të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqësuesit.**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi debat lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës, se a ka ndonjë vërejtje apo propozim përveç Kërkesës për mbajtjen e Forumit për Trashëgiminë Kulturore e cila ka arritur nga MKRS.

Pasi nuk kishte propozime tjera, kryesuesi propozoi të vazhdohet me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 15.01.2009.

2. Shqyrtimi i implementimit të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Agim Veliu, kryetar - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha, se si Komision jemi pajtuar që të fillojmë punën me monitorimin dhe zbatimin e Ligjeve të miratuara në Kuvend. Propozimi i Komisionit është që të fillojë me monitorimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e komisionit se për këtë mbledhje është ftuar Ministri i Kulturës, mirëpo për arsye të obligimeve të shumta nuk ishte prezent dhe në këtë mbledhje prezantuan përfaqësuesit nga Ministria, Skënder Boshtrakaj dhe Naser Hoti.

Kryesuesi hapi debat lidhur me këtë pikë.

Gani Buçinca, ai propozoi që t'i dëgjojmë përfaqësuesit e Ministrisë, të marrim vërejtjet dhe propozimet e tyre. Gjithashtu, propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohet Ministri i Kulturës njëkohësisht të ftohen edhe përfaqësues nga Agjencioni për të drejtat e autorit. Në bazë të opinioneve të marra, ne si komision do të marrim vendim për procedim të mëtutjeshëm në Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Të gjithë anëtarët e komisionit u pajtuan me këto propozime.

Kryesuesi fjalën ua dha përfaqësuesve të ministrisë.

Skënder Boshtrakaj, prezantoi para Komisionit disa nga rezultatet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe sfidat kryesore që ka MKRS në mekanizmat për zbatimin e Ligjit..

Ligji për të drejtat e autorit është një ndër prioritetet e Planit të Qeverisë në kuadër për partneritet Evropian por në mungesë të ekspertizës së nevojshme dhe kufizimeve për punësime të reja, theksoi se nuk janë arritur rezultate të duhura. ne si Ministri jemi të obliguar të raportojmë për këtë fushë në Institucionet Evropiane.

Sipas nenit 169.1 dhe nenit 169.2 të këtij Ligji, Ministria duhet të themelojë Zyrën për pronën intelektuale e cila zyre ende nuk është themeluar.

Kjo çështje duhet të zgjidhet me amendamentimin e Ligjit ose me nxjerrjen e akteve nënligjore.

Puna e realizuar deri më tani është e konsiderueshme por e pamjaftueshme sa i përket detyrave që dalin nga ky ligj, për këtë MKRS-ja ka identifikuar ca dokumente të rëndësishme të cilat duhet të hartohen gjatë vitit 2009, siç janë: draft rregullat

1) mbi ndërmjetësimin, 2) mbi aprovimin e tarifave nga Qeveria dhe 3) mbi regjistrimin.

Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta sigurohet nga Agjencionet ndërsa zyra e Qeverisë i certifikon këto Agjencione, ua jep të drejtën për të përfaqësuar të drejtën autoriale por nuk regjistron vepra autoriale, por vetëm monitoron procesin dhe nuk hynë në marrëdhënie kontraktuese.

Për tu regjistruar veprat autoriale nevojitet zyra për arshivë, e cila zyrë ende nuk është hapur.

Kryesuesi- parashtrori pyetjen se a e ka paraparë Ministria plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit në Strategjinë Legjislative. Ai theksoi, se në Ligj ekziston një Rregullorja e UNMIK-ut e cila është pengesë për zbatimin e Ligjit, apo Komisioni të fillojë procesin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta që ai të jetë i implementueshëm.

Përfaqësuesi i Ministrisë - theksoi se ekzistojnë disa çështje të cilat e pengojnë moszbatimin e Ligjit.

Pengesë kryesore për moszbatimin e Ligjit është mos themelimi i Agjencionit për të drejtat e autorit në Kosovë. Në Ligj parashihe se autorët kanë të drejtë të organizohen dhe të bashkë organizohen për administrim kolektiv për të drejtat e tyre ku certifikimin e tyre duhet tua jep zyra e cila ende nuk është themeluar. Në Ministri nuk janë paraqitë asnjë kërkesë nga institucionet për certifikim pasi nuk kanë adresë të caktuar.

Sfidë tjetër për moszbatimin e Ligjit është se Gjykatat dhe mediatorët kanë nevojë për trajnime dhe profesionalizëm të mëtutjeshëm në këtë fushë, që të integrohen me përvojat më të reja të Bashkimit Evropian. Te ne ende nuk ekziston kapaciteti i brendshëm për të ofruar këto specializime.

Ministria duhet të dalë para Komisionit me disa propozime për amendamentim të Ligjit, që Ligji sa më parë të jetë i zbatueshëm.

Kryesuesi – falënderojë përfaqësuesit e ministrisë për të gjitha të dhënat rreth zbatueshmërisë së ligjit. Ai shtoi, se ne në mbledhjen e radhës, si Komision do ta ftojme Ministrin që më për së afërmi të na njoftojë lidhur me pengesat e zbatimit të këtij Ligji; sa udhëzime administrative ka nxjerr ministria që ligji të jetë i zbatueshëm dhe a ka paraparë Ministria e Kulturës plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit në Planin strategjikë për vitin 2009.

Në vazhdim shtoi, se pas marrjes të të gjitha fakteve Komisioni do të vendosë se a do të thirren grupe të interesit. Komisioni, më pas do të nxjerrë Raport me rekomandime.

Në vijim diskutuan anëtarët e Komisionit.

Mark Krasniqi - mendon se ekzistojnë disa ndërmarrje botuese të cilat e keqpërdorin të drejtën autoriale. Ai theksoi se ana materiale e autorit është mjaft e dëmtuar

Diskutoi rreth disa autorëve që gjatë botimit të librit nuk ia vejnë emrin e botuesit, tirazhin etj, të cilat elemente duhet ti ketë libri. Pra ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit është çështje urgjente që të mbrohen të drejtat autoriale me Ligj.

Gani Buçinca - vlerëson se si prioritet për monitorimin e ligjeve kemi caktuar Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, i cili Ligj duhet të jetë i zbatueshëm në praktikë. Propozoi se kur të bëhet rishikimi i buxhetit, të bëhet presion në Qeveri që të ndahen mjete shtesë për mbrojtjen e të drejtave autoriale.

Ai diskutoi lidhur për disa çështje thelbësore të cilat janë pengesë për zbatimin e ligjit.

Një, është problemi juridik. Ligji ka mangësi dhe si i tillë nuk mund të zbatohet.

Çështja e dytë, është aspekti financiar. Ministria e Kulturës duhet të paraqet koston financiare, sa mjete nevojiten për hapjen e zyrës së Agjencionit.

Çështja e tretë, është aspekti organizativ- profesional, kush do ti licencojë autorët, cilat vepra autoriale janë me vlerë.

Duhet të rregullohet edhe çështja e krijimit të Agjencioneve private të cilat do të veprojnë në kuadër të ligjit dhe të cilat do të jenë të licencuara nga Qeveria.

Ai shtoi, se të drejtat autoriale mund të mbrohen vetëm duke u thirrur në Ligj.

Heset Cakolli - lidhur me këtë pikë tha se ne do ti presim propozimet nga Ministria e Kulturës, në cilën pjesë Ligji ka nevojë të ndryshohet, sa ka nxjerrë udhëzime administrative. Ne si Komision do ti shqyrtojmë të gjitha propozimet e marra dhe do të nxjerrim rekomandime që Ligji të jetë i zbatueshëm.

Adem Hajdari – mendon se me këtë Ligj janë të shkelura të drejtat autoriale dhe propozoi se Ligji duhet sa më parë të amendamentohet që të jetë i zbatueshëm në praktikë.

Kryesuesi – kërkoi nga përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës që lidhur me zbatueshmërinë e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta t'i dërgojë Komisionit këto informacione:

- cilat janë vështirësitë që pengojnë zbatueshmërinë e Ligjit;
- a ka paraparë Ministria e Kulturës plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit në Planin Strategjikë për vitin 2009;
- sa udhëzime administrative ka nxjerrë Ministria e Kulturës;
- a janë themeluar trupat e nevojshëm për funksionim të Ligjit.

3. Të ndryshme

Komisioni shqyrtoi Kërkesën e MKRS-së për pjesëmarrje të një anëtari të komisionit në Forumin për Trashëgiminë Kulturore, e cila do të mbahet me 28.01.2009 në Muzeun e Kosovës.

Komisioni, vendosi që pjesëmarrës në këtë Forum të jetë Enis Kervan.

Për mbledhjen e ardhshme Komisioni konsideron se duhet ftuar Ministrin e Kulturës Rinisë e Sportit për të debatuar lidhur me implementimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Mbledhja përfundoi në orën 12,15

Kryetari i Komisionit,

Agim Veliu